



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-024
Prishtinë, më 15 mars 2018, në orën 17:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 MARS 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala, Xhavit Haliti, Aida Dërguti dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme, e filluar më 22, 23 dhe 28 shkurt 2018, me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Kryesia, pasi diskutoi për pikën e lartshënuar, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit t'i vazhdojë punimet të martën, më 20 mars 2018, në orën 16:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 17:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri Veseli

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale